
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data 16.02.2026

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE NDARË NË TRE LOTE”

LOTI 1 -“FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE DIESEL, GAZOIL 10 PPM”

LOTI 2 - “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE, BENZINË PA PLUMB”

LOTI 3-"LËNDË DJEGËSE E LËNGËT PËR PËRDORIM TERMIK DHE INDUSTRIAL, ME
GAZOIL <0.1"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: “Furnizim me lëndë djegëse” me fond limit të përgjithshëm 242,092,597.86 (dyqind e dyzet e dy milion e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 2,510,552.71 (dy milion e pesëqind e dhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e një) euro pa TVSH, ndarë në 3(tre) lote:

Loti 1 -“Furnizim me lëndë djegëse diesel, Gazoil 10 ppm” me fond limit: 71,318,619 (shtatëdhjetë e një milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 739,589.54 (shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e katër) euro pa TVSH

Loti 2-“Furnizim me lëndë djegëse, Benzinë pa plumb” me fond limit 777,006 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 8,057.72 (tetë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e dy) euro pa TVSH

Loti 3-"Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik dhe industrial, me Gazoil <0.1" me fond limit 169,996,972.86 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 1,762,905.45 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 16/02/2026 është 96.43 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë dyzet e tre) euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

Përfshirë të gjitha Lotet

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Loti 1 : “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil 10 ppm)”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për tregtimin me shumicë të karburantit, objekt prokurimi

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, 5) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë edhe me furnizim me bot, furnizim i cili mund të ofrohet vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumicë. Në procedurën e prokurimit me objekt Loti 1: “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil 10 ppm)” me afat të marrëveshjes kuadër deri në 36/Muaj janë përfshirë kërkesat e 6 (gjashtë) autoriteteve kontraktore përfituese ku janë përcaktuar si mënyrë lehtërimi të lëndës djegëse Gazoil 10 ppm është përcaktuar dhe furnizimi me anë të botit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor Përfitues, Spitali Rajonal Vlorë. Autoriteti Kontraktor OBP është i detyruar të kërkojë paraqitjen e licencës së tregtimit me shumicë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me qëllim garantimin e përmbushjes me sukses të kontratës. Theksojmë se kemi të bëjmë me të njëjtën lëndë djegëse Gazoil 10 ppm dhe ajo që ndryshon është mënyra e lëvrimit.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”*, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”*, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”* Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion të tregtimit me pakice të karburanteve:

- në Bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakice të karburanteve sipas tabelës nr.1;
- në Bashkitë/Njësitë Administrative të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas tabelës nr 2;
- në akset rrugore kryesore të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas tabelës nr 3 ;

Operatori ekonomik duhet të paraqes listen e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës së mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qendër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Kavajës		
3	Përgjatë Rrugës së Durrësit		
4	*Etj.....		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Durrës		
2	Lushnje		
3	Vlorë		
4	Etj		

Tabela nr.3 orientuese

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Lushnje		
2	Tiranë-Vlorë		
3	Tiranë-Korçë		
4	Etj		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

*Shenim 3.1:

Ne zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakice si më poshtë:

-Ne pronësi dhe/ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar leshuar nga QKB;

-Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

*Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licencë leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe intineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë. Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore si p.sh Spitali Rajonal Vlorë, Spitali I'hsan Cabej”Lushnje, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Devoll, Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Vlorë dhe Prefekti i Qarkut Vlorë ushtrojnë aktivitetin e tyre jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në Bashkinë e Tiranës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numri i autoriteteve që e kane seline dhe operojnë kryesisht në kete bashki.

Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 3 të tilla në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, qe jane pjese e kesaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vëmendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesëmarrëse ne tender e ushtrojne veprimtarine e tyre edhe jashte bashkive ku kane selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme per akses ne furnizim ne akset kryesore te vendit.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve eshte kerkuar sipas parashikimit te pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane te se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, ne kushtet kur kemi te bëjmë me furnizim me kartë elektronike, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 1 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Theksojmë se të gjitha Bashkitë/Njësitë Administrative të caktuara në Tabelën 1, 2 dhe 3 të këtij kriteri janë orientuese. Rrjedhimisht, kërkesa është e bazuar në ligj dhe lidhet ngushtë me objektin e kontratës dhe zbatimin e saj

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.3 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vertetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesisë përgjatë vitit 2025

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjatë vitit 2025.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (web page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr.561, datë 29.7.2016 Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të Karburantit në Njësitë E Qeverisjes së Përgjithshme” 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmerinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvrimit të sasive të karburantit. Fotografimi i mjetit konsiston në fotografimin e targës së makinës, momentin e furnizimit të automjetit dhe pikën e karburantit ku firmizohet automjeti me qëllim verifikimin e furnizimit të mjeteve gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara me lart. Te gjitha pikat e parashikuara me lart ofrohen nga faqja e menaxhimit të karburantit nëpërmjet të cilit Autoritetet Kontraktore përfituese menaxhojnë shpërndarjen dhe informohen në cdo kohë me lëvizjet që kryhen me sasine e karburantit të prokuruar. Faqja e menaxhimit të karburantit vihet në dispozicion të Autoritetit Kontraktor që me lidhjen e kontratës dhe nëpërmjet kësaj faqe Autoriteti menaxhon sasine e karburantit nga lidhje e kontratës/marrëveshjes kuadër deri në përfundimin e tyre duke garantuar transparencë totale në menaxhimit e sasive dhe shpërndarjes së karburantit . Vendosja e këtij kriteri është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje mjedisore të tipit B, të leshuar nga QKL, Akt-Teknike leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese minimalisht 500 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni i siperpermendur është kërkuar sipas parashikimit të pikes III “Kushtet për pajisjen me licencë të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë

se disponojnë dokumentacionin perkatës dhe kapacitetin minimal te depozitave prej 500 m³, kapacitet minimal i cili është kusht për pajisjen me licence tregtimi nga autoritetet kompetente shtetërore.

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) autobot/ autocisternë me kapacitet mbajtës minimalisht 5 000 litra, të cilin mund ta ketë në pronësi ose meqira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikaten për transportin e lendeve të rrezikshme dhe pashaporten e mjetit perkapacitetin mbajtes ne litra.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, *me anë të* se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor përfitues, Spitali Rajonal Vlorë, ka kërkuar furnizim me lëndë djegëse Gazoil 10 ppm me bot, sipas sasisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar besim se operatori ekonomik fitues do të përmbushi me sukses këtë kontratë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me lëndë djegëse me autobotin/ autocisternën e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor perfitues duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lendeve djegëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me bot sipas kerkesave te parashikuara me lart. (referuar shtojcës 7 për lotin 1 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Shënim

Për operatorin ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, nëse dokumentet e kërkuara nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë, operatori ekonomik i huaj duhet të paraqesë dokumentet ekuivalente me to në përmbushje të secilin prej këtyre kriterëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2 : “Furnizim me lëndë djegëse, (Benzinë pa plumb)”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% i vlerës së fondit limit të lotit. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a)Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet

e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të ulët se 20 % të fondit limit, rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor i përmbushjes së kontratës dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor në bindje se Operatori ekonomik fitues përmbush dhe realizon me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion te tregtimit me pakice te karburanteve:

- në Bashkinë Tiranë të ketë të paktën 1 (një) stacion te tregtimit me pakice te karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- në Bashkitë/Njësitë Administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve
- në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listen e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qendër (Unaza e Vogël)		
2	Etj..		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Vlore		
2	Etj..		

Tabela nr.3 orientuese

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë - Vlorë		
2	Etj		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

Shenim 3.1:

Ne zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve

me pakice si me poshte:

- Ne pronesi dhe/ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e regjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe intineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë. Në këtë procedurë prokurimi merr pjesë vetëm një autoritet kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë që ushtrojnë aktivitetin e tij në Vlorë. Në vendosjen e një numri minimal prej 1 stacioni në tregtimi me pakice te karburanteve në Bashkine e Tiranës është marrë parasysh vetëm në rast se Spitali Rajonal Vlorë do ketë raste të transportimin të pacientëve nga Spitali Rajonal i Vlorës drejt Qendrave Spitalore te Tiranës.

Në vendosjen e një numri minimal prej 1(një) stacioni tregtimi me pakice te karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 1(një) të tillë në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efijencë dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, qe jane pjese e kesaj procedure, duke patur parasysh se autoriteti Kontraktor Perfitues eshte Qender Shendetesore dhe per rrjedhoje mund te ushtron veprimtarinë e tij edhe jashte qytetit.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve eshte kerkuar sipas parashikimit te pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane te se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, ne kushtet kur kemi te bëjmë me furnizim me kartë elektronike, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 1 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.3 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve ne fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise përgjatë viteve 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjate vitit 2025.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike te personalizuar me targen e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet kartave elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (web page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targen e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofrojte edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofrojte edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te

eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me ane të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakice me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr.561, datë 29.7.2016 Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të Karburantit në Njësitë E Qeverisjes së Përgjithshme” 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmerinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvrimit të sasive të karburantit. Fotografimi i mjetit konsiston në fotografimin e targës së makinës, momentin e furnizimit të automjetit dhe pikën e karburantit ku furnizohet automjeti me qëllim verifikimin e furnizimit të mjeteve gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart. Të gjitha pikat e parashikuara më lart ofrohen nga faja e menaxhimit të karburantit nëpërmjet të cilit Autoritetet Kontraktore përfituese menaxhojnë shpërndarjen dhe informohen në cdo kohë me lëvizjet që kryhen me sasine e karburantit të prokuruar. Faja e menaxhimit të karburantit vihet në dispozicion të Autoritetit Kontraktor që me lidhjen e kontratës dhe nëpërmjet kësaj faqe Autoriteti menaxhon sasine e karburantit nga lidhje e kontratës/marrëveshjes kuadër deri në përfundimin e tyre duke garantuar transparencë totale në menaxhimit të sasive dhe shpërndarjes së karburantit . Vendosja e këtij kriteri është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Shënim

Për operatorin ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, nëse dokumentet e kërkuara nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë, operatori ekonomik i huaj duhet të paraqesë dokumentet ekuivalente me to në përmbushje të secilin prej këtyre kriterëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 3: "Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik dhe industrial, me Gazoil <0.1"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për tregtimin me shumicë të karburantit, objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, 5) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknikedhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë edhe me furnizim me bot, furnizim i cili mund të ofrohet vetëm nga shoqëritë e tregëtimit me shumicë. Në procedurën e prokurimit me objekt Loti 3: "Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik dhe industrial, me Gazoil <0.1" me afat të marrëveshjes kuadër deri në 24/Muaj është përfshirë kërkesat e 1 (një) autoriteti kontraktor përfitues ku është përcaktuar dhe furnizimi me anë të botit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor Përfitues, Spitali Rajonal Vlorë.*

Autoriteti Kontraktor OBP është i detyruar të kërkojë paraqitjen e licencës së tregtimit me shumicë të operatorëve ekonomikë pjesmarrës me qëllim garantimin e përmbushjes me sukses të kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”*, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët

duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit . Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a)Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.3 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesisë përgjatë vitit 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete pergjate vitin 2025.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Vërtetim teknik te leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknikte leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, për depozitat e tregtimit qe vërteton kapacitetet depozituese minimalisht 500 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, per te garantuar vazhdimesi ne furnizim, sipas kerkesave te autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni i sipërpermendur është kerkuar sipas parashikimit te pikes III “*Kushtet për pajisjen me licencë të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me ane te se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë dokumentacionin perkatës dhe kapacitetin minimal te depozitave prej 500 m³, kapacitet minimal i cili është kusht për pajisjen me licence tregtimi nga autoritetet kompetente shtetërore.

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) autobot/ autocisternë me kapacitet mbajtës minimalisht 5 000 litra, të cilin mund ta ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me sipër operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, certifikaten për transportin e lendeve të rrezikshme dhe pashaporten e mjetit perkapacitetin mbajtes ne litra.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, shërbimi i furnizimit me bot është kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe disponimi i nje mjeti te tille me kapacitet minimal prej 5 000 litrash është plotësisht i argumentuar dhe ne proporcion me natyrën e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklarate në bazë të se ciles merr persiper furnizimin me lëndë djegëse me autobotin/ autocisternën e tij dhe shpenzimet e tij deri në vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor perfutues duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane të se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me bot sipas kërkesave të parashikuara me lart. (referuar shtojcës 7 për lotin 3 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Shenim:

Për operatorin ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, nëse dokumentet e kërkuara nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë, operatori ekonomik i huajduhet të paraqesë dokumentet ekuivalente me to në përmbushje të secilin prej këtyre kriterëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

SHTOJCA 6

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Loti 1: “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil 10 ppm)”

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590:2022 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Loti 2: “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Loti 3-Furnizim me lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil <0.1)

Lënda djegëse (Gazoil <0.1%) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH UNI 6579:2011 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” argumenton se me qëllim parandalimin e pasojave në raste dështimi të procedurës si qendër terciare dhe ka impakt të drejtëpërdrejtë në ofrimin e shërbimit ndaj pacientit, furnizimi me lëndë djegëse, për përdorim termik, civil dhe industrial duhet të plotësojë specifikimet e kërkuara, standartet e kërkuara ose standarte të tjera, të barasvlefshme ose ekuivalente me të dhe përmbajtja e sqfurit nuk duhet të tejkalojë 0.1 % të masës.

Në përputhje me pikën 2.15 Seksioni 2 “Objekti i kontratës” në DST, ku parashikohet se lejohen oferta me variante, ofertuesit mund të oferojnë me variante/alternativë të karburantit (Gazoil <0.1%) S SH UNI 6579:2011, me specifikime të njëjta ose më të mira. Në këtë rast ofertuesi duhet t’i referohet çmimeve të bursës për karburant (Gazoil <0.1%) sipas Buletinit të Prokurimeve Publike.

Për më shumë referojuni katalogut të standardeve “Blerje karburanti, me përjashtim të vajcurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupet e punës të ngritura nga Autoritete Kontraktore Përfituese si dhe referuar katalogut të standarteve “Blerje karburanti, me perjashtim të vajgurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët”, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Standartet e paraqitura në katalogun e sipercituar janë standarte të blera nga ana e Organit Qendror Bleres prej Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) si Organi Kombëtar i Standardizimit në Republikën e Shqipërisë. Nga komunikimi shkresor që kemi patur me DPS-ne, ka sqaruar se ka detyrimin të adoptojë si standarte shqiptare (SSH) standartet europiane në mënyrë identike dhe pa ndryshime në tekstin origjinal. Si rrjedhim, referencat e normativave në përmbajtje të standartit janë pjesë e tekstit origjinal të standarteve të huaja dhe për këtë arsye nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime.

Për sa më lart, duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në brendësi të standarteve që shet, as Organi Qendror Bleres në rolin e blerësit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime. Në këto kushte sqarojmë se për çdo standart të përmendur në brendësi të çdo standarti kryesor lejohet paraqitja e ekuivalentit të tij, qoftë ai dhe Standarti Shqiptar (SSH).

Njësia e prokurimit në pikën 2.15 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) ka parashikuar lejimi i varianteve për Lotin 3 me objekt: *“Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik dhe industrial, me Gazoil <0.1%”*, për shkak si më poshtë:

1.Për shkak të anulimit të disa procedurave të zhvilluara nga Organi Qendror Blerës për lëndët djegëse (Gazoil <0.1%, Gazoil >0.1%, Mazut), të cilat nuk janë finalizuar me shpallje fituese, është krijuar një situatë pasigurie në furnizim, me risk real për ndërprerje të shërbimit.

2.Autoriteti Kontraktor Përfitues, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), si institucion shëndetësor terciar me funksion jetik në ofrimin e shërbimit ndaj pacientëve, ka paraqitur kërkesë të argumentuar për lejimin e produktit Gazoil 10 ppm si alternativë të pranueshme dhe të barasvlefshme me Gazoil <0.1% paraqitur si më poshtë vijon:

Nga komunikimet zyrtare ndërmjet QSUNT dhe Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) rezulton se:

-Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ka konstatuar që për vitin 2025 ky institucion nuk ka bërë asnjë procedurë të kontrollit cilësor para zhdoganimit për produktin (Gazoil <0.1).

-ISHTI sqaron se lënda djegëse për përdorim për ngrohje duhet të plotësojë kërkesat e standartit Gazoil ≤ 0.1 % për përdorim industrial S SH UNI 6579:2011 dhe se Gazoil 10 ppm ka përmbajtje më të ulët të squfurit dhe impakt më të mirë mjedisor.

➤ Referuar specifikimeve teknike të produktit Gazoil 10 ppm, ky produkt i plotëson specifikimet teknike të Gazoil <0.1 madje i tejkalon ato. Gazoil 10 ppm ka 0.001 % squfur, pra është shumë më i pastër se kërkesa minimale e standartit S SH UNI 6579:2011. Gazoil 10 ppm ka më pak blozë, më pak erë, djegie më e mirë dhe e pastër për të cilën nuk dëmton djegësin, më pak ndotje.

- Nisur edhe nga specifikimet e dhëna nga operatori ekonomik i cili bën mirëmbajtjen e kaldajave në QSUT ku citon se të gjitha janë të prodhuara për të funksionuar me lëndë djegëse gazoil me densitet 820 deri në 845 kg/m³ i cili përmbushet nga të dyja produktet Gazoil <0.1 dhe Gazoil 10 ppm.
- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ku argumentohet se me qëllim parandalimin e pasojave në raste dështimi të procedurës si qendër terciare dhe impaktit të drejtëpërdrejtë në ofrimin e shërbimit ndaj pacientit, furnizimi me lëndë djegëse, për përdorim termik, civil dhe industrial duhet të plotësojë specifikimet e kërkuara, standartet e kërkuara ose standarte të tjera, të barasvlefshme ose ekuivalente me të dhe përmbajtja e squfurit nuk duhet të tejkalojë 0.1 % të masës.

NJËSIA E PROKURIMIT